



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DËJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje me Mekanizëm Bujqësor

**(Subvencione në kuadër të sektorëve: Lavërtari, Perimtari, Pemëtari,
Vreshtari)**

Gjakovë, Qershor 2025

Në bazë të nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe nenin 10 dhe 14 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës së Gjakovës me Nr. 01/110-01-3560 të datës 04.02.2020, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) :

Njofton fermerët e Komunës së Gjakovës, që mund të aplikojnë për skemën e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetjen e tyre me pajisje (mekanizëm bujqësor):

- **Spërkatëse dhe Shpërndarëse Plehu**
- **Freza 1.8m,**
- **Pllug 3 Brazd Statik,**
- **Motokultivator 4.4 KW,**
- **Motokultivator 9.0 KW,**
- **Mikser për përgatitjen e ushqimit të kafshëve min. 2M3 – vertikal,**
- **Mbjellëse e grurit 16 rendshe,**
- **Rotokosa 165**

Kriteret :

- Ndarja proporcionale sipas rajoneve – pesë (5) rajone;
- Fermeret femra, minoritetet dhe të rinjtë kanë përparësi;
- Përfituesit duhet të bashkë financojnë vlerën e pajisjes minimum 20%;
- Aplikuesit të mos jenë përfitues të Subvencioneve nga Komuna nga viti paraprak dhe viti aktual;
- Përfituesi duhet të jetë banor i Komunës së Gjakovës;
- Fermeri ka të drejtë të aplikojë vetëm për një pajisje dhe të dorëzojë një Aplikacion;
- Te jete aplikues ne Pagesa Direkte ne kuadër të MBPZHR-se (për vitin 2025);
- Aplikuesit për Spërkatëse dhe Shpërndarëse të plehut duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 3.00 ha tokë të punueshme (kultura lavertare) dhe së paku 2.00 ha tokë të punueshme (kulture perimtare) të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Pllug duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 5.00 ha tokë të punueshme (kultura lavertare) të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Freza duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 1.00 ha tokë të punueshme, së paku 0.50 ha peme, së paku 0.50 perime dhe së paku 0.20 vreshta të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Motokultivator 4.4KW duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 0.50 ha perime, së paku 0.50 ha peme, së paku me 0.20ha Vreshta, së paku 0.10 ha serre dhe së paku 1.00 ha lavertari të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Motokultivator 9.0 KW duhet të kenë në pronësi (ose me qera) së paku 3.00 ha perime, së paku 3.00 ha me peme dhe së paku 2.00 ha vreshta të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Mikser për përgatitjen e ushqimit të kafshëve duhet të kenë së paku 20 Lope qumështore (përparësi kanë kush ka më shumë Lope qumështore) të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Mbjellëse të grurit duhet të kenë së paku 10 ha (kulture lavërtarë) të kultivuar dhe të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025,
- Aplikuesit për Rotokosa duhet të kenë së paku 10 lope qumështore, së paku 100 Dele qumështore, së paku 100 dhi qumështore, së paku 10 viça për majmëri të aplikuar ne Pagesa Direkte 2025.

VEREJTJE: Për te gjithë aplikuesit do te verifikohen të dhënat e te mbjellave dhe krerëve nga sistemi EFR / Pagesat Direkte 2025 ne kuadër te Ministrisë se Bujqësisë, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Numri identifikues i fermerit;
- Vërtetimi i tatimit në pronë;
- Vërtetimi i Gjedheve nga Veterinari (për aplikuesit e pajisjeve Rotokosa dhe Mikser për përgatitjen e ushqimit te kafshëve);
- Certifikata mbi pronësinë e paluajtshme - Lista poseduese;
- Deklarata ne betim.

Fletë aplikacioni tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (DBPZHR) të Komunës së Gjakovës.

Afati i aplikimit: **05.06.2025 deri me 19.06.2025**